



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E SHENDETESISE  
DREJTORIA SHERBIMIT SPITALOR “DR.STEFAN GJONI”  
KRUJE

Rruga Nene Tereza, Lagjia nr 1, Kruje, Albania TEL: +355 511 2 2006

[spitalikruje@shendetesia.gov.al](mailto:spitalikruje@shendetesia.gov.al)

Kruje me 06.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

*“ Blerje Materiale Konsumi Mjekesore per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Dr. Stefan Gjoni ” Kruje ”.*

- KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (33140000-3;33141100-1;33141114-2;33141121-4;33141125-2;33141200-2;33141240-4;33141320-9)

*“Blerje Materiale Konsumi Mjekesore ”* procedure e hapur thjeshtuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

*3 234 480 (tre miljon e dyqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë ) lekë pa tvsh*

*Loti I-re Materiale mjekimi te pergjithshme per nevojat spitalore me fond limit 1 614 745( nje milion e gjashtëqind e katërmbedhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e pese ) leke pa tvsh*

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

### **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.( Nuk është i aplikueshem)

**1-a)**Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2024 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator)*

**Shenim-**Per të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2023 të lëshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2021 për secilin operator)*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Per të provuar përmbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet të plotësojë kërkesat minimale si më poshtë duke dorëzuar :

**a)**Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3(tre) vitet financiare (2021,2022,2023 ) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të

kontrates (lotit nr 1), qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **645 898 (gjashtëqind e dyzet e pese mije e teteqind e nentedhjetë e tete ) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.3-a) plotësohet duke paraqitur edhe vërtetimin përkatës të Administratës Tatimore

### **2.3-Kapaciteti teknik:**

**2.3-1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës (lotit nr .1), që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se **322 949 (treqind e njëzet e dy mije e nenteqind e dyzet e nente ) leke pa t.v.sh**

, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)**-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

**b)**-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.5-a)**Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë mallrat objekt kontrate, në vendet e percaktuara nga ana e Drejtorisë së Sherbimit Spitalor “Dr. Stefan Gjoni “Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK sipas kushteve të percaktuara në kontratë..

**Shenim:** Në zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

- . Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës , në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

- ✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.
- ✓ Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.
- ✓ Operatori ekonomik duhet të paraqitur vetdeklarim për permbushjen e afatit të skadencës; jo më të vogël se 12 muaj nga data e levrimit të mallit në destinacion
- ✓ Kërkohe të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar pranë DSHS-Kruje
- ✓ Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikujt të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet

**2. Pajisjet mjekesore ( Materiale Mjekimi) te jene te certifikuara ne CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave te aprovuara. Kjo pike mund te plotesohet edhe nepermjet paraqitjes së autodeklaratës/deklaratë konformiteti (DC), nga operatori ekonomik.**

**Argumentim:** Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”(nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

**3. Kërkohe të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë/kuqe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqip ose anglisht)**

**Argumentim:** Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike.

**4. Neqoftese ka dokumenta ne gjuhe te huaj ato duhen te jene te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara .Te gjithe dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mosdorezimit te nje dokumenti , ose te dokumentave te rreme e te pasakta , konsiderohen si kusht per skualifikim .**

**6. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2008 ose 9001:2015 për distribuim, tregëtim të pajisjeve mjekësore Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar**

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates për trejetim të materialeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklaratë që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është i çertifikuar konform standarteve të cilësisë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentim:** Ky kriter vendoset në përputhje me të nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me certifikimin e cilësisë së mallrave objekt prokurimi.

e) **Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas ligjit 89/2014**

## II Argumentimi i specifikimeve teknike

Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia	SASIA
	<b>Garza, Bende, të tjera konsumable të përgjithshme</b>			
1	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm <sup>2</sup>	Copë	100
2	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitesë e mbrojtur me leter të shqiteshme	Copë	30
3	Bende me parafine 10x10cm	Sterile, jo me shume se 10 cope per pako	Copë	10
4	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	100
6	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë	500
7	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 16pala; paketim individual (1 cope/pako)	Copë	4000

8	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm <sup>2</sup> , me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm <sup>2</sup> fibrile kolageni ose ekuivalent	Copë	2
9	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensioni i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë	500
10	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear	2500
11	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materjali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .	Copë	1000
12	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g	Copë	800
13	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik	Copë	2500
14	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë	1000
15	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padepertueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë	500
16	Solucion pastrimi per optike	Per pastrimin e lenteve, siperfaqeve optike dhe fibrave optike te endoskopeve. Tubet 4-5 gram.	Copë	2
18	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë	20000
19	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë	30000
20	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me reze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale	8000
21	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë	1000
22	Filter baktericid	per respirim artificial, antibakterial, HMEF	Copë	10
23	Qarqe respiratori	per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm	Copë	10
24	Tuba Guedel	Nr. 00, 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	Copë	20

25	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë	50
26	Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet	10
27	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë	5
28	Tub drenimi	silikon, rulon 20-30m, diam. 6-8mm dhe 8-10mm	meter	20
29	Dilatator metalik vezikal me veshe metalik	C 16	Copë	2
30	Kateter arterial	20G-22G Seldinger	Copë	30
31	Kapese kordoni umbilikal		Copë	200
32	Zhgute		Copë	100
33	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8, 10	Copë	10
34	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë	50
35	Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi	Ch 8, 10	Copë	10
36	Tub endotrakeal 7.5	ID 7.5 mm, nazo-oral, me ballon	Copë	20
37	Tub endotrakeal 8.0	ID 8.0mm, nazo-oral, me ballon	Copë	10
38	Maske Laringeale PVC	Maske PVC me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë	3
39	Maske Laringeale Silikon	Maske Silikon me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë	1
40	Kateter me ballon per hemoragjine pas lindjes	Set steril per nderprerjen dhe menaxhimin e hemoragjise pas lindjes. Seti : Kateter silikoni Fr 24-25 me kanal per monitorim drenimi, ballon 500-600 mL, shiringe 50/60mL, set infuzioni, valvul 2-rrugeshe	set	2
41	Spekulum vaginal	Steril, nje perdorimesh.	Copë	100
42	Set punkcioni pleural	Set i perbere nga age veres, kateter drenimi 9-12Fr gjatesi 40÷50cm, qese drenimi min.2000ml, me valvul hyrese dhe shkarkimi.	Copë	5
43	6-12 kanale		Copë	20
44	Leter CTG	Leter per kardiotokograf	Copë	50

45	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë	10
46	Elektroda Defibrillatori	Cift elektroda per defibrilator njeperdorimeshe me konektor. Sterile. (modeli i pajisjes do te percaktohet nga autoriteti kontraktor)	set	4
47	Aparat tensioni	Me manometer	Copë	20
48	Spatula ( druri )	Sterile, e paketuar individualisht	Copë	5000
49	Set per identifikimin e nenes dhe femijes	Me dy pjese per doren e nenes dhe doren e femijes ne ngjyra te dallueshme	set	100
50	Gojez spirometrike		Copë	300
51	Filter spirometrik antibakterial		Copë	300
52	Set ngrohës per lageshtues	Set i perbere nga: tel ngrohës, adaptor, sensor nonitorues per lageshti- temperature per qark pacienti me lageshtues.	set	2
53	Sensor oksimetrie neonatal	Per monitor pacienti; set njeperdorimesh neonatal me sensor oksimetrie dhe kabllin perkates	Copë	2
54	Sisteme transfuzioni gjaku	Per monitore pacienti. Shumepedorimesh	Copë	100

### 2.3-Kapaciteti teknik:

**2.3-1.** Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit me një vlerë jo me te vogel se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës (**lotit nr .1**), që prokurohet dhe konkretisht jo me pak se **322'949 (treqind e njetzet e dy mije e nenteqind e dyzet e nente ) leke pa t.v.sh**

, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)**-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

**b)**-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.



**2.3.5-a)**Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizoje/transportoje mallrat objekt kontrate, në vendet e percaktuara nga ana e Drejtorise së Sherbimit Spitalor “Dr. Stefan Gjoni” “Kruje me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkeses së AK sipas kushteve të percaktuara në kontrate..

**Shenim:** Në zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.*

*Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontrates , në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorezuar perben kusht s’kualifikimi.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.
- Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.
- Operatori ekonomik duhet të paraqitur vetdeklarim për permbushjen e afatit të skadences;jo me të vogël se 12 muaj nga data e levrimin të mallit në destinacion
- Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar pranë DSHS-Kruje
- Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet

## **NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK:**

---

<sup>2</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021